



PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Lëndët vepruese: Metalaxyl-M & Folpet

PËRMBAJTJA

Metalaxyl-M : 5 %

Folpet : 40 %

Lëndë ndihmëse : 55 %

Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë (WG)

**FUNGICID SISTEMIK, ME VEPRIM PARAMBROJTËS DHE SHËRUES,
SPECIFIK PËR KONTROLLIN E VRUGUT TË HARDHISË.
TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.**

PRODHUESI : SYNGENTA Crop Protection AG, Basel, Switzerland
KUJDES



- Mund të shkaktojë reaksion alergjik lëkure.
- Shkakton irrim të rëndë të syve.
- I dëmshëm nëse thithet.
- Dyshohet se shkakton kancer.
- Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata.

MASAT PARAMBROJTËSE

• Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit. • Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën.
• Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. • Evitoni thithjen e pluhurit/ tymit/
gazit/ mjegullës/ avullit/ aerosolit. • Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. • Pas pune duart dhe
fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. • Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

Këshilla të përgjithshme: Merrni ambalazhin, etiketën apo SDS me vete kur thërisni numrin e urgjencës, qendër të kontrollit të helmimeve ose mjekun, ose kur shkoni trajtim.

• **Në rast se mirret me organet e frymëmarrjes,** nxireni të aksidentuarin në vend të ajrosur mirë, nëse frymëmarrja është e çrregulluar ose ndaluar, stimuloni frymëmarrje artificiale. Mbani pacientin ngrohtë dhe në qetësi. Telefononi menjëherë mjekun ose qendrën e kontrollit të helmimeve.

• **Në rast kontakti me lëkurën,** hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani pjesët e trupit të

kontaminuar me ujë të bollshëm e të pastër. Nëse acarim i lëkurës vazhdon, thërrisni mjekun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni.

• **Në rast kontakti me sytë** i lani menjëherë me ujë të bollshëm e të pastër për të paktën 15 minuta. Hiqni lentet dhe kërkonti ndihmë mjekësore.

• **Në rast gëlltitje** kërkonti menjëherë këshilla mjekësore dhe i tregoni ambalazhin ose etiketën. Mos PROVOKONI të vjella.

ANTIDOTI: Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

**Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin,
ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.**

**Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.
Mos i lani pajisjet e spërkatjes pranë ujrave sipërfaqësore.**

Për të mbrojtur organizmat ujorë, lini një zonë mbrojtëse të patrajtuar prej **5 metrash** nga ujërat sipërfaqësore.

MËNYRA E PËRDORIMIT: Me spërkatje.

PËRDORIMI:

Përdoret në **HARDHI** kundër vrugut (*Plasmopara viticola*) me dozë 200 gr/100 litra ujë. Kryhen 3-4 trajtime gjatë vegetacionit. Bëhen trajtime parambrojtëse (kur kushtet e motit favorizojnë shfaqjen e vrugut), që fillojnë në fazën e rritjes intensive dhe përsëriten çdo 10 – 14 ditë.

VËREJTJE: RIDOMIL GOLD COMBI 45 WG ka efekt të pjesëshëm kundër Nekrozës së hardhisë (*Phomopsis viticola*), Kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*), Kalbëzimit të zi të rrushit (*Guignardia bidwelli*) dhe Njollësjes së kuqe të hardhisë (*Pseudopeziza tracheiphila*).

MËNYRA E PËRGATITJES SË TRETËSIRËS SPËRKATËSE: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit, duke vazhduar përzierjen, dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara. Të mos përdoret në fidanishtet e hardhisë.

PËRZIHET me shumicën e fungicideve dhe insekticideve që përdoren në hardhi.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES: Hardhi 21 ditë.

UDHËZIME PËR TËRHEQJEN E SIGURT TË PRODUKTIT DHE PAKETIMIT : Shishet bosh të ambalazhit shpëlahen me ujë nën presion ose shpëlahen tre herë (uji i shpëlarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.

PERIUDHA DHE KUSHTET E RUAJTJES: 5 vjet. Preparati ruhet në kuti të mbyllura, në vende të thata e të ftohta. Evitoni ruajtjen në temperatura nën -10⁰ C dhe mbi 35⁰ C. Preparati të mos mbahet në diell e në lagështi.

Nr dhe data e regjistrimit: 27/2, date 13.02.2026.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 1 kg.

Data e prodhimit: _____;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 5 vjet;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Tipi i ambalazhit baze: Material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia; .

Emri dhe adresa e prodhuesit: Syngenta Crop Protection AG. Adresa: Bazel, Switzerland;

Emri dhe adresa e Aplikantit: Syngenta Crop Protection AG. Adresa: Bazel, Switzerland.

